



JAVA E DEMOKRACISË VENDORE

PROGRAMI I AKTIVITETEVE

31 MAJ - 5 QERSHOR 2021

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Co-PLAN
Agjencia për planifikim dhe bashkëpunim
në nivelin lokal dhe bashkiqësor

E HËNE, 31 MAJ 2021 – DITA 1: VULLNETARIZMI

Çdokush mund të ndërlidhet me bashkësinë e e tij dhe të ndihmojë në përmirësimin e saj edhe përmes gjërave të vogla, që ndryshojnë jetët e njerëzve. Vullnetarizmi dhe përfshirja në komunitet kanë treguar se mund të sjellin përfitime si për komunitetin ashtu edhe për vetë vullnetarët. Si mund të nxitet më tej vullnetarizmi në Shqipëri?

TIRANË
10:00 – 15:00

Konferenca Kombëtare e Vullnetarizmit 1.0

Organizuar nga Beyond Barriers

**ROGNER HOTEL
GARDEN**

Konferenca do të sjellë bashkë aktorë të rëndësishëm nga institucionet vendore e kombëtare tek organizatat dhe qytetarët., duke bërë të mundur që përmes një dialogu të hapur, pjesëmarrësit të shprehin qendrimet e tyre dhe të paraqesin propozime, të cilat më pas do të mund të përfshihen në një Letër Politikash. Kjo Letër Politikash do të përmbajë edhe një analizë të përmbledhur dhe propozime konkrete për të përmirësuar mjedisin mundësues për vullnetarizmin në Shqipëri. Në këtë ngjarje do të paraqiten gjetjet e Studimit Kombëtar mbi Vullnetarizmin si dhe platforma e parë numerike mbi vullnetarizmin në Shqipëri.

E MARTË, 1 QERSHOR 2021 – DITA 2: FINANCAT VENDORE DHE SHËRBIMET

Autonomia financiare është një element kyç i decentralizimit të vërtetë, ndaj sa më e madhe të jetë kjo autonomi aq më mirë është. Duke qenë më afër qytetarëve, bashkitë kanë një përparësi krahasuar me nivelet e tjera të qeverisjes, që i mundëson të trajtojnë më mirë nevojat e qytetarëve përmes investimeve dhe dhënies së shërbimeve vendore. Për të shfrytëzuar këtë përparësi, bashkitë duhet të kenë burime financiar të mjaftueshme, që planifikohen dhe shpenzohen në mënyrë të pavarur. Prej këtej buron rëndësia e të ardhurave të veta, që përfshijnë të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore.

TIRANË
10:00 – 13:00

Konferenca Vjetore mbi Financat Vendore

Organizuar nga Co-PLAN

**ROGNER HOTEL
GARDEN**

Përveç paraqitjes së Raportit Vjetor mbi Gjendjen e Financave Vendore për vitin 2020, këtë vit, kjo ngjarje do të shërbejë edhe për të paraqitur edhe Vëzhgimin mbi Perceptimin Qytetar mbi taksat vendore, si dhe të nxisë dialogun mbi taksat e bashkive përkundër ofrimit të shërbimeve publike vendore.

GRAMSH
17:30 – 19:00

Diskutim i hapur mbi buxhetin

Organizuar nga Euro-partners Development, Agenda Institute, Urban Research Institute (URI)

**PALLATI I
KULTURËS**

Kjo veprimtari do të përqendrohet në Bashkinë Gramsh si një rast studimor. Në Gramsh janë duke u zbatuar tre projekte të rëndësishme me mbështetjen e LevizAlbania. Në këtë bashki, qytetarët kanë shprehur përparësitë e tyre për buxhetin e vitit 2021 përmes platformës buxhetim.al të ngritur nga Instituti Agenda. A u morën parasysh këto prioritetet? Buxheti i vitit 2021 u përkthye në një gjuhë më të kuptueshme nga Euro-Partners Development, me qëllim që të ishte më transparent për qytetarët. A ishin qytetarët më të ndërgjegjshëm? Shërbime të ndryshme publike po monitorohen nga një grup qytetarësh të mbështetur nga URI. A po përdoret buxheti për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët?

E MËRKURË, 2 QERSHOR 2021 – DITA 3: ANGAZHIMI QYTETAR

Shqipëria ndodhet në një pikë të rëndësishme të proceseve demokratizuese, por qytetarët e saj nuk janë të angazhuar sa duhet, në mënyrë që të sigurohet një demokraci funksionale, veçanërisht në nivelin vendor. Siguria që qeverisja vendore punon në interes të publikut kërkon një angazhim të informuar, të organizuar, aktiv dhe përfshirës. Me qëllim që të kuptojmë më tepër se ssi të nxisim angazhimin qytetar na duhet të eksplorojmë çfarë e shtyn dhe çfarë e pengon angazhimin e një personi si qytetar.

TIRANË
11.00 – 13.00

Recycling process as a citizen's engagement model

Organizuar nga Insituti per Konsulencë në Marketing dhe Menaxhim (IMMC)

**SHKOLLA E
MESME ISMAIL
QEMALI**

Ngjarja përmblylëse e projektit “Zero Mbetje” do të zhvillohet në Shkollën e Mesme Ismail Qemali në Tiranë. Gjatë kësaj ngjarjeje do të paraqitet kurrikula “Zero Mbetje” para të rinjve, mësuesve dhe drejtuesve të shkollës, duke shpjeguar e mbështetur futjen e procesit të riciklimit në shkollat e mesme. Shkollës do t'i dhurohen gjithashtu kosha mbeturinash për të realizuar riciklimin e mbetjeve.

Në përfundim nxënësit do të realizojnë një lojë me role, e cila ka si objektivi të bëjë më të kuptueshëm konceptet e ekonomisë qyrkulluese, për të rinjtë, faktorët që ndikojnë vendimmarrjen mbi menaxhimin e mbetjeve, si dhe qendrimet dhe sjelljen e aktorëve të ndryshëm. Loja do të përmirësojë aftësitë e të rinjve për të kryer kërkime dhe për të debatuar.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Co-PLAN

<p>TIRANË 18:00 – 19.00</p> <p>PARKU RINIA</p>	<p>Panairi i Fjalës i Kampionëve të Demokracisë</p> <p>Organizuar nga LevizAlbania</p> <p>Prej vitit 2015 LevizAlbania ka mbështetur mbi 65 individë me prejardhje të ndryshme, të cilët kanë kontribuar personalisht apo përmes angazhimit në organizata apo grupe informale. Mbështetja e LevizAlbania ka pasur ndikim në komunitete të ndryshme, por ka patur gjithashtu ndikim edhe në vetë individin që ka udhëhequr njënjëshmëri në bashkësinë e tij. Përmes kësaj veprimtarie, LevizAlbania synon të thellohet në natyrën e këtij ndikimi. Kampionët tanë të demokracisë do të ndajnë historitë e tyre, të përqendruara në ndryshimin personal/profesional si dhe në ndryshimet në komunitetet e tyre.</p>
--	---

E ENJTE, 3 QERSHOR 2021 – DITA 4: FUQIZIMI I TË RINJËVE

Angazhimi qytetar është gjithnjë e më shumë duke u njohur si një përbërës i rëndësishëm për fuqizimin e të rinjve, sepse ndihmon në mbrojtjen e kapitalit njerëzor e shoqëror. Praktikata e angazhimit qytetar kanë një ndikim të madh në edukimin e të rinjve mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetarë, duke i lejuar ata të zhvillojnë aftësi të vlefshme për rritjen e tyre. Cilat janë rrugët përmes të cilave angazhimi qytetar i të rinjve kthehet në një mundësi të pjesëmarrjes politike, ekonomike e shoqërore? Cilat janë mundësitë dhe sfidat që prekin këtë potencial?

<p>MALIQ 9:30 – 11.00</p> <p>SHKOLLA 9 vjeçare AGIMI</p>	<p>Rëndësia e përfshirjes së të rinjve në politikat për infrastrukturën e shkollave të tyre</p> <p>Organizuar nga Democracy Education Training, TED</p> <p>Kjo veprimtari do të përfshijë nxënësit nga dy shkolla 9-vjeçare si dhe përfaqësuesit e Bashkisë. Qellimi i veprimtarisë është të diskutohet mbi problemet e identifikuara dhe propozimet për zgjidhje të studentëve, sa i takon gjendjes fizike të shkollave të tyre. Nxënësit do të advokojnë për plane konkrete për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe përfshirjen e tyre në projekt buxhetin e bashkisë. Projektet fituese, të hartuara nga nxënësit do t'i paraqiten dëgjuesve, si dhe do të diskutohen mekanizma për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse vendore.</p>
<p>CËRRIK 10:00 – 11.00</p> <p>SHESHI I QYTETIT</p>	<p>Iangurimi i Stendës Sportive “Fëmijët vijnë të parët”</p> <p>Organizuar nga Qendra për Edukim dhe Sporte “SKILLS”</p> <p>Qendra do të mbështesë të rinjtë vendas të ngrenë një Stendë Sportive “Fëmijët vijnë të parët” në qendër të qytetit. Stenda do të qendrojë në sheshin kryesor të qytetit për një muaj dhe do të shërbejë për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e sportit për fëmijët, të rinjtë dhe gjithë komunitetin. Stenda sportive do të pajiset me mjete, si: porta të vogla minifutbolli, bar artificial, kosha basketbolli, rrjeta volejboli, do të shpërndajë informacion dhe mesazhe ndërgjegjësuese, etj. Ideja e stendës është në funksion të përgatitjes së terrenit dhe marrjes së mbështetjes nga komuniteti për të advokuar për caktimin e fondeve në buxhetin e Bashkisë për të siguruar afrimin e fëmijëve tek sporti.</p>
<p>LEZHË 10:00 – 12.30</p>	<p>Fushatë derë më derë mbi riciklimin</p> <p>Organizuar nga H.A.N.A.</p> <p>H.A.N.A. është një organizatë rinore, e angazhuar në promovimin e një skeme të riciklimit në burim, në Bashkinë Lezhë. Pilotimi do të kryhet në lagjen më të madhe të qytetit, duke shkuar derë më derë për të informuar dhe përfshirë qytetarët në këtë nismë të rëndësishme. Pilotimi do të mbështetet nga Bashkia përmes vendosjes së koshave të përshtatshëm për ndarjen e mbetjeve. H.A.N.A. do të përpiqet më tej për të përfshirë skemën e riciklimit në Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë.</p>
<p>ELBASAN 15:00 – 16.30</p> <p>KALAJA</p>	<p>Youth speak –up</p> <p>Organizuar nga Partners Albania</p> <p>Projekti Lëvizja rinore – Një Faqe e Re për Komunitetet Vendore ka vënë në lëvizje të rinjtë në qytete të ndryshme të vendit, duke i edukuar me ndjenjat e vullnetarizmit, aktivizmit dhe përgjegjshmërisë, duke rritur aftësitë dhe njohuritë e tyre, si dhe duke forcuar marrëdhëniet mes të rinjve dhe komuniteteve vendore për një demokraci më të fortë. Të rinjtë përfaqësues të 8 nismave të nxënësve nga shkollat e mesme në Durrës, Pogradec, Tirana dhe Elbasan do të ndajnë përvojën e tyre si dhe do të bëhen pjesë e një diskutimi të hapur mes nxënësve, shkollave dhe përfaqësuesëve të qeverisjes vendor.</p>

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



Co-PLAN
Agjencia për planifikim dhe zhvillim të bashkëpunimit

E PREMTE, 4 QERSHOR 2021 – DITA 5: MJEDISI YNË I PËRBASHKËT

Përmes mbështetjes së nismave të mëparshme dhe të tanishme për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe mjedisit ku jetojmë, është bërë më e qartë se pjesa më e madhe e pengesave, rreziqeve dhe mundësive lidhen në thelb me çështje të demokracisë, pjesëmarrjes publike, vendimmarrjes transparente dhe përfshirjes së grupeve të marginalizuara.

<p>VAU DEJËS 10:30</p> <p>SHESHI I QYTETIT</p>	<p>Dita e Krimbit të Mëndafshit</p> <p>Organizuar nga Gratë Artizane në Vau Dejës</p> <p>Veprimtaria do të angazhojë të rinj dhe nxënës në një rradhë punëtorishë dhe diskutime mbi rëndësinë e politikave për punësimin e të rinjëve si profesionistë dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Do të marrë pjesë edhe Kryetari i Bashkisë Vau Dejës. Grupimi do të paraqesë edhe një stendë me punime të të rinjëve, si dhe do të shpjegojë mënyrën e rritjes së krimbit të mëndafshit.</p>
<p>SHKODËR 11:30</p> <p>HOTEL ROSE GARDEN</p>	<p>Lojë me role “E drejta mbi qytetin”</p> <p>organizuar nga GO2</p> <p>Përmes lojës, Organizata GO2 do të mundësojë vizatimin urban të një qyteti krijues për fëmijët. Propozimi do të zhvillohet në bashkëpunim me të rinjtë, për tu ndërtuar në pjesën juglindore të qytetit të Shkodrës, poshtë Kodrës së Tepes, përballë fshatit Kuç. Loja “E drejta mbi qytetin” synon të bëjë më të kuptueshme për pjesëmarrësit sfidat me të cilat përballen aktorë të ndryshëm të përfshirë në zhvillimin e qytetit, si qytetarët, qeverisja vendore, sipërmarrësit, pronarët, shoqëria civile, grupet e prekshme, etj., përmes angazhimit praktik për zgjidhjen e një çështjeje të propozuar në lojë. Pjesëmarrësit do të kenë rolet e tyre në lojë, si dhe agjendat dhe objektivat përkatës, për arritjen e të cilave ata duhet të bashkëpunojnë dhe negociojnë me njëri tjetrin.</p>
<p>SHKODËR 18:00 – 20:15</p> <p>PROMENADE</p>	<p>Hapja e ekspozitës fotografike</p> <p>Organizuar nga Forumi Liqeni i Shkodrës</p> <p>Lumi Buna dhe Liqeni i Shkodrës vijojnë të ndoten nga shkarkimi i ujërave të zeza të 140 mijë banorëve të qytetit. Ujërat vijojnë të patrajtuara në perëndim të qytetit, aty ku liqeni takohet me Lumin Buna. Bazuar në një vëzhgim të plotë në terren, grupe qytetarësh të angazhuar në dokumentimin sistematik të ndotjes në Lumin Buna – Liqenin e Shkodrës, do të paraqiten rreth 200 fotografi, si dhe video. Ekspozita do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar mbi abuzimet me burimet ujore si dhe me denoncimin kriminel mjedisor, duke tërhequr vëmendjen e autoriteteve mbi këtë problem shqetësues. Të rinj vullnetarë do të informojnë vizitorët, për të rritur ndërgjegjësimin dhe shikueshmërinë. Hapja e ekspozitës do të shoqërohet nga një veprimtari artistike e të rinjve të ansambli “Ramadan Sokoli”.</p>

E SHTUNË, 5 QERSHOR 2021 – DITA 6: DHËNIA E NJË SHËMBULLI

Cila mënyrë më e mirë për të ndikuar te të tjerët sesa dhënia e një shëmbulli? Të Shtunën, 5 Qershor 2021, Dita Botërore e Mjedisit, stafi, përfituesit dhe bashkëpunëtorët e Leviz Albania do të angazhohen vullnetarisht në një pastrimin e një lumi.

<p>KURBIN 9:00 – 10.30</p> <p>LUMI MAT, URA E ZOGUT</p>	<p>Veprimtari pastrimi vullnetar në Lumin Mat</p> <p>Organizuar nga LevizAlbania</p> <p>LevizAlbania po mbështet nisma dhe angazhimin qytetar, me synimin për të krijuar një rradhë efektsh pasuese për nxitjen e qytetarëve për tu bërë aktivë dhe për të kërkuar përmirësimin e shërbimeve dhe forcimin e demokracisë. Përmes dhënies së shëmbullit të mirë në pastrimin e një pjese të brigjeve të Lumit Mat, LevizAlbania do të bashkohet me vullnetarë të tjerë për të nxitur aksionin për mjedis më të mirë.</p>
<p>KURBIN 10.30 – 12.30</p> <p>LUMI MAT, URA E ZOGUT</p>	<p>Promovimi i turizmit në Lumin Mat</p> <p>organizuar nga Besnik Hidri</p> <p>Kjo veprimtari synon ndërgjegjësimin dhe angazhimin e komunitetit në mbrojtjen e Lumit Mat, duke treguar qartë mundësitë e mëdha për ta kthyer lumin në një pikë turistike. Të rinj dhe nxënës, si dhe komuniteti e përfaqësues nga qeverisja vendore do të diskutojnë mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, si dhe të promovimit të turizmit në zonë. Në pjesën e dytë të veprimtarisë pjesëmarrësit do të kenë mundësin të bëjnë shëtitje në Lumin Mat me kanoe.</p>

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

